

AKTI I THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“TOGU CONSTRUCTION-24 SHPK”

Unë, Besnik Togu, i biri I Dautit dhe Havase, i datelindjes 25/10/1963, banues ne **Kavaje, shtetas shqiptar** i identifikuar nga me **ID.G31025030T**, që në vijim do te quhet **“Ortak”**

Sot me date **03/01/2024**, vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“TOGU CONSTRUCTION-24 SHPK”** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Ndertim, projektim i veprave industriale dhe civile, autoshkolle, makina me qira ,import, eksport, etj.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje :

“TOGU CONSTRUCTION-24 SHPK”

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : Lagjja nr 4, bulevardi "Indrit Cara", ndertese 2- kateshe, kati i pare, godina nr.5525,Kavaje,Tirane.

2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4.Shoqeria do te kete vulen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

4.6. Ortaku ka te drejte te beje propozime, si dhe emeroge e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likuidatoret

Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte *100.000* (njqind mije) leke.

6.2. Z. Besnik Togu ne cilesine e ortakut te vetem do te posedoje 1 kuote 100% me vlere 100.000 leke.

Kreu IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaku i Vetem ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe eksperti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaku i Vetem i shoqerise